



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.40/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Violeta Husaj Rugova kryesues, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 28 dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 26.12.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.40/2025 e datës 25.12.2025, e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 28 dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 25.12.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendohet se aktivistët e LVV-së, kishin vërejtur se ishin vendosur materiale zgjedhore (fletushka/broshura zgjedhore), me përmbajtje promovuese të kandidatës Arjeta Salihu Abazi, dhe subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, në xhamat e përparmë të automjeteve private të parkuara në hapësira publike në lagjen Ulpiana. Tuje kanë shtuar se vendosja e këtyre materialeve është bërë pa pëlqimin e pronarëve të automjeteve, duke i shfrytëzuar automjete private si hapësirë për shpërndarje propagandistike, gjë që përbën shkelje të rregullave të fushatës zgjedhore dhe cenon parimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Kjo bie në kundërshtim edhe me parimin e barazisë së garës zgjedhore, me të drejtën për zgjedhje të lira dhe të ndershme, si dhe me standardet themelore të demokracisë, duke u dhënë disa subjekteve politike një avantazh të padrejtë përmes shfrytëzimit të hapësirave të palejuara. Kanë kërkuar nga PZAP që ta pranojë ankesën si të bazuar dhe të shqiptoj gjobën sipas legjislacionit përkatës.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si prova fotografi në cilat shihen njoftimet e shpërndara.

Në përgjigjen në ankesë dorëzuar me datë 25.12.2025, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës kanë theksuar se pretendimet se vendosja e materialit zgjedhor nga kandidatja e KLDK-së, në vetura përben shkeljeje zgjedhore nuk qëndron, ngase në asnjë dispozite ligjore qoftë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme as Rregullore përkatëse një veprim i tillë nuk ndalohej e as nuk ndëshkohen, për me tepër as nuk parashihet, qoftë në mënyrë direkte apo indirekte. Tutje kanë theksuar këto pretendime nuk kanë bazueshmëri ligjore, asnjë nen të cilit i referohet sepse nuk ka rregullim ligjor e as nënligjor për pretendimin e saj. Barra e provës i bie ankuesit, por i njëjti nuk i është referuar asnjë rregulli dhe nuk ka arritur ta provojë një gjë të tillë, as me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme e as me Rregulloren nr. 07/2024, nuk ka asnjë dispozite apo nen që flet për një kufizim të tillë apo pretendim të ankueses, për më tepër e njëjta ankesën e ka pa specifikim të shkeljes apo dispozitës ligjore apo nënligjore të shkelur, por vetëm përgjithshëm paraqet ankese në një supozim pa mbështetje ligjore. Kanë kërkuar nga PZAP që ta refuzoj ankesën si të pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës, se Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka shpërndarë material zgjedhor/njoftime në xhamat e përparmë të automjeteve private janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk provuar shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 i cili përcakton” *Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim, paragrafi 2.2 vendosa e njoftimeve, pllakateve dhe postëreve , ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, ne shenjat e trafikut publik, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna, ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizata ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve”,* pasi që në fotografitë e bashkangjitura në ankesë shihen vetëm disa njoftime me përmbajtje të fushatës zgjedhore, ndërsa nuk dihet vendi, ku konsiderohet se ka ndodhur shkelja e supozuar, dhe nuk dihet se kush e ka vendosur materialin zgjedhor.

Në bazë të provave të bashkangjitura shkresave të lëndës dhe pretendimet e palës ankuese paneli vlerësoi se pretendimi ankimor për shpërndarjen e njoftimeve në xhamat e përparme të automjeteve private janë të paqëndrueshme dhe si të tilla Paneli i refuzoi për faktin se subjekti politik LVV nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi, nuk ka arritur që të vërtetoj vendin ku konsiderohet se ka ndodhur shkelja e supozuar dhe se këto veprime janë ndërmarr nga subjekti politik kundër të cilit është paraqitur ankesa, për të ardhur në përfundim se janë bërë shkelje të dispozitave të lartcekura të Nenit 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe sipas Rregullore NR.01/2025 për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosijes së Ankesave, neni 5, paragrafi 1. nën paragrafi 1.3 ankesat që dorëzohen në PZAP për shqyrtim duhet të përmbajnë këto të dhëna: 1.3.Vendin Kohën, datën dhe orën kur ka ndodhur shkelja, ku në rastin konkret parashtruesi i ankesës nuk ka dhënë hollësi që të dihet se ku janë shpërndarë këto njoftime, në cilën orë ka ndodhur shkelja e pretenduar dhe nga

provat e ofruara nuk mund të identifikohet objekti se ku ka ndodhur shpërndarja e materialeve zgjedhore, andaj në prani të këtyre rrethanave ankesa është refuzuar si e pabazuar.

Kështu që paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësit e supozuar kanë shpërndarë material zgjedhor në hapësira të palejuara konkretisht në ndërtesa, nuk është dëshmuar me prova nga pala ankuese, përkatësisht provat e ofruara nuk përmbushin objektivat ligjore për të provuar shkeljen e pretenduar..

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.40/2025 më datë 26.12.2025

Kryesues i Panelit
Violeta Husaj Rugova



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.